



Prishtinë, 12.06.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2758_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2506_03_24** i datës 12.03.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 08.04.2025.

në seancën e mbajtur më datë 12.06.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit D. M., nga fsh. Bogë, Komuna e Pejës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2506_03_24 i datës 12.03.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 12.03.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2506_03_24 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit, lidhur me kontestimin e borxhit të energjisë elektrike në shumën prej 605.72 €, me pretendimin që i njëjti është i parashkruar, ashtu që, në fuqi kishte mbetur Vendimi i Departamentit për Kujdes ndaj Konsumatorëve të KESCO-s, i dt. 24.10.2023.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori D. M., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori e njofton Bordin që Vendimin e ka pranuar me vonesë, andaj, data e parashtrimit të ankesës është brenda afatit ligjor, pas pranimit të vendimit;
- Lidhur me parashkrimin e borxhit, konsumatori ka parashtruar padi pranë gjykatës kompetente;
- Konsumatori kërkon që të rikyçet në rrjetin e energjisë elektrike, pasi që ndërprerja e energjisë përbën shkelje të të drejtave të konsumatorit dhe është në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, derisa të ketë një vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.06.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 08.04.2025; Vendimin e DMK të datës 12.03.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 20.10.2023; Përgjigjen e KESCO-s të datës 24.10.2023, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 14.12.2023; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Konsumatori me datë 20.10.2023 ka parashtruar ankesë në KESCO, duke e kundërshtuar në tërësi borxhin e energjisë elektrike, me kërkesën që i njëjti të shlyhet, duke u thirrur në dispozitat ligjore të LMD-së, që e rregullojnë çështjen e parashkrimit ose vjetërsisë së borxhit. Pas shqyrtimit, ankesa ishte refuzuar nga KESCO-ja, me pretendimet që kalkulimi dhe faturimi është i saktë, sipas gjendjes së regjistruar në njehsor dhe në kartelën e konsumatorit nuk është reflektuar ndonjë gabim në faturim dhe borxh. I pakënaqur me vendimin e KESCO-s, konsumatori me datë 14.12.2023 i është adresuar DMK-së në ZRRE, me kërkesën që borxhi të shlyhet, nën pretendimet se i njëjti është parashkruar dhe se konsumatori është i gatshëm që të paguaj vetëm pjesën e borxhit të akumuluar për një vit, gjegjësisht vitin e fundit, pasi që pjesa tjetër është parashkruar.

Bordi ka analizuar Transaksionet e konsumatorit, dhe ka gjetur se, i njëjti është regjistruar në KESCO që nga data 17.08.2010, kur edhe ishte faturuar për shërbimin e kyçje s me faturën per shërbime nr.101-DPE10S025730 në vlerë **116 €** si dhe i është hapur shifra DPR-9040001. Siç mund të shihet edhe në shkresa të lëndës, konsumatori nuk e ka paguar as këtë obligim financiar karshi të licencuarit KESCO/KEDS. Më tutje, vihet re që konsumatori kishte faturim të ulët, për shkak të konsumit të ulët të energjisë elektrike, dhe një pjesë e madhe e faturimit përfshin vetëm faturimin me taksa. Konsumatori përpos dy pagesave që i ka realizuar, një pagesë në vlerë prej 20 € me datë 04.05.2012 dhe një tjetër me datë 27.04.2016, në vlerë prej 20 € dhe deri në momentin e shqyrtimit të kësaj ankese, konsumatori nuk e ka realizuar asnjë pagesë tjetër ndaj Furnizuesit KESCO, pra nuk i ka shlyer obligimet e tij ligjore për energjinë të cilën e ka shpenzuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 5 – Furnizimi me Energji Elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ashtu që: *“Konsumatorët janë të obliguar që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji, të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRrE-ja”.*

Bordi më tutje ka analizuar edhe listat e leximit të konsumatorit, dhe ka gjetur se, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, në shumicën e rasteve, nuk kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit, dhe kjo përsëri në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në Pronë të Konsumatorit – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin*



e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm. 3. Refuzimi i paarsyeshëm dhe i vazhdueshëm i konsumatorit që t'i lejojë qasje në pronë ndërmarrjes së energjisë, mund të pasoj shkyçja sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

Për më tepër, Furnizuesi e mban të drejtën që në rast që një konsumator nuk i shlyen obligimet financiare për shërbimet e pranuar, të njëjtin mund ta shkyçë nga rrjeti elektrik, dhe atë në përputhje me nenin 5 – Shkyçje për mos pagesë të energjisë – të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, si në vijim: *“Ndërmarrja e energjisë mund ta shkyçë konsumatorin i cili nuk i përmbahet afatit të pagesës sipas dispozitave të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, nenit 14 par. 1 dhe nenit 15 par. 1 i kësaj rregulle apo në kontratën për furnizim”.*

Lidhur me kërkesën e konsumatorit për parashkrim të borxhit, Bordi ka gjetur se, nuk është kontestuese fakti që DMK e ka njoftuar konsumatorin që ZRrE nuk e shqyrton këtë natyrë të ankesave, dhe rrjedhimisht, konsumatori duhet t'i adresohet gjykatës kompetente dhe kjo duke u bazuar në nenin 341 – Rregullat e Përgjithshme të Parashkrimit – citoj: *“Gjykata (theksi i shtuar) nuk mund ta merr parasysh parashkrimin në qoftë se debitori nuk thirret në atë”.* Kësisoj, konsumatori e ka njoftuar ZRrE-në që ka parashtruar padi në gjykatë duke e kontestuar në tërësi këtë borxh, duke iu referuar kështu institutit të parashkrimit, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërkaq, lidhur me kërkesën e konsumatorit për rikycje, Bordi ka gjetur se, konsumatori pas parashtrimit të ankesës DMK e ka njoftuar KESCO-n që lënda e tij është në proces, andaj edhe konsumatori është rikycur në rrjetin e energjisë elektrike, pra as rikycja e konsumatorit nuk është kontestuese.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, Transaksionet, Listat si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **D. M.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.